

Njohja e diplomave të huaja

Nëse në Zvicër doni të bëni një arsimim ose ngritje të mëtejme, apo kërkoni një vend pune, me rëndësi është të gjeni klasifikimin e saktë në tregun e punës. Ju duhet t'i krahasoni diplomat dhe përfundimet shkollore të arritura në vendin tuaj të prejardhjes me kërkesat e Zvicrës.

Keni përfunduar arsimimin në vendin tuaj dhe keni marrë një diplomë, dëshmi përfundimi apo ndonjë certifikatë tjetër, një vërtetim apo konfirmim? Ju mund ta kontrolloni këtë diplomë dhe kështu të mund të kuptoni se çfarë „Vlere“ ka diploma juaj në Zvicër.

Me këtë, punëdhënësit më mirë mund të vlerësojnë, nëse jeni i përshtatshëm për një vend pune: një vërtetim i tillë, edhe pse nuk është garanci për vend pune, i shton shanset tuaja në tregun e punës. Dhe, institucionet arsimore mund të shohin, nëse i plotësoni kushtet për një arsimim apo ngritje të mëtejme. Ndoshta është e udhës të bëni një arsimim shtesë në një degë të caktuar për të ardhur deri te një diplomë e nivelit federal.

Varësisht nga fusha e arsimimit, në Zvicër ekzistojnë institucionet të ndryshme, të cilat mund të vërtetoni nivelin tuaj shkollor, profesional dhe kualifikimin e arritur, dhe këtu mund të kërkoni njohjen e diplomës ose të kualifikimit. Shumica e faqeve të internetit në rreshtat e mëposhtëm ju informojnë në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht, ndonjëherë edhe në anglisht .

Diplomat universitare

Kompetent për to është Konferenca e Rektorëve të shkollave të Larta të Zvicrës:

<https://www.swissuniversities.ch/fr/services/reconnaissance-swiss-enic>

Nëse njihet matura juaj profesionale, diploma profesionale ose matura e gjimnazit si mundësi për studime në Zvicër, vendosin vetë shkollat e larta.

Diploma e arsimimit profesional dhe e shkollave të larta universitare

Kompetent për fushat e arsimimit profesional (fusha sociale, industri, artizanat, tregti, fusha komerciale, gastronomi, amvisëri, ekonomia e shërbimeve etj.) është Sekretariati Federal për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion SEFRI:

www.sbf.admin.ch > formation > reconnaissance des diplômes étrangers

Aty e gjeni edhe listën e institucioneve, të cilat në çështjen e njohjes së diplomave, janë kompetente për sektorët e tyre. Këtu bëhet fjalë në veçanti për diplomat në fushën teknike dhe teknologji informative, arkitekturë, ndërtim dhe planifikim, kimi dhe shkencat shoqërore, bujqësi dhe pylltari, ekonomi dhe shërbime, dizajn, punë sociale, muzikë, teatër dhe arte të tjera si dhe linguistikë (gjuhësi) e aplikuar.

Kriteret për njohje:

- Arsimimi juaj (përfshirë këtu edhe shkollimin e detyrueshëm) duhet të ketë zgjatur sa një arsimimi i krahasueshëm në Zvicër.
- Përveç mësimit teorik, arsimimi juaj duhet të përmbajë edhe përvoja praktike.
- Arsimimi juaj duhet të ketë përfunduar me provime, të cilat janë të njohura nga shteti.
- Shkollimi juaj duhet të ekzistojë edhe në Zvicër dhe duhet të lidhet me një profesion, i cili është i rregulluar me Ligjin mbi aftësimin profesional.

- Ju duhet të jeni në gjendje të dëshmoni se keni arritur një nivel të caktuar gjuhësor (B2 deri C2 sipas Kornizave Gjuhësore Referuese të Hapësirës Evropiane).

BE/EFTA (Asociacioni Evropian i Tregtisë së Lirë)

Zvicra dhe BE/EFTA i njohin reciprokisht diplomat e për profesionet e rregulluara me ligj nga shteti. Sekretariati Federal për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion ju informon mbi procedurat dhe institucionet kompetente.

Profesionet e rregulluara

Profesionet e ndryshme në Zvicër janë të rregulluara me ligj. Kjo domethënë, se për ushtrimin e këtij profesioni kërkohet njohja zyrtare. Kjo është e nevojshme për shembull për profesionet në fushën e shëndetësisë, fushën e arsimit, në punë sociale ose në profesione juridike. Shembuj: Inxhinier/e ndërtimi, inxhinier/e gjeomatikës, avokat, punëtorë social, mësues/e, logoped, mjek/e, dentist/e, veterinar/e, farmacist/e dhe shumë të tjera.

Institucionet kompetente

Shëndetësi

Profesionet jo universitare (p.sh. infermiere, fizioterapist, këshilltare ushqimi): Kryqi i Kuq Zvicëran www.redcross.ch

Profesionet medicinale universitare (p.sh. mjek, dentist, veterinar, farmacist) Enti Federal për Shëndetësi BAG: www.bag.admin.ch

Psikolog/e: Komisioni profesional për psikolog psyko@bag.admin.ch

Osteopat (mjekues natyror me vënien e dorës): Konferenca e Drejtorëve Kantonalë të Shëndetësisë www.gdk-cds.ch

Arsimi: mësues/e, terapist/e gjuhëtar/e, pedagog/e shërues, terapist/e i/e fiziko-motorikes: Konferenca Zvicërane e Drejtorëve të Arsimit www.cdip.ch
Arsimimii nxënësve arsimimin profesional: Enti Kantonal për Arsimin Profesional www.csfp.ch

Drejtësi: Gjyqet kantonale. Në faqen www.csfp.ch gjendet një listë e institucioneve kompetente për fushën e drejtësisë.

Teknika: Varësisht prej kantonit, profesionet si arkitekt/e dhe inxhinier/e janë të rregulluara. Informacionet i gjeni nën www.swissuniversities.ch.
Profesioni i inxhinierit për gjeomatikë (gjeodezi, hartografi dhe kadastër) duhet të shënohen në regjistrin e gjeomatikëve. Informacionet i gjeni nën: www.cadastre.ch.

Ekonomi: gastronomi: Enti Kantonal për Punë i kantonit ku zhvillon aktivitetin lokal i gastronomisë: www.ch.ch
Auditor/e, ekspert/e të auditimit: Zyra Federale për Mbikëqyrje të Auditorëve www.rab-asr.ch.

Punë sociale: Për profesionin punëtor/e social/e kompetent është Sekretariati Federal për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion: www.sbf.admin.ch.

Pavarësia ekonomike: Enti Kantonal për Punë: www.ch.ch.